

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

Proçesi i Aplikimit për Shkollën e Mesme

Këshilla për Prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara

Në rast se, fëmija juaj me aftësi të kufizuara aplikon për në shkollat me Kritere Pranimi (*Special Admission*) dhe ato me Pranim të Gjërë (*Citywide Admission*), ju duhet të:

- Qëndroni në kontakt me këshilltarin psikolog të fëmijës suaj përse i përket Proçesit të Aplikimit për në shkollën e mesme. Aplikimet pranohen jo me vonë se **16 Nentor 2007**. Plotësoni dhe **ktheni Pyetsorin për Prindërit/Kujdestarët** menjëherë tek **këshilltari psikolog** i shkollës së fëmijës suaj. (shiko mbrapa kësaj letre)
- Kërkoni një takim me ekipin e IEP^{së}, nëse është e nevojshme, për të folur mbi përparimin e fëmijës suaj në mësim dhe sjellje, mbi programet dhe proçesin e seleksionimit në shkollën e mesme dhe nëse ndonjë program ka përjashtime në kërkesat e pranimit dhe fëmija juaj mund të plotësojë këto kërkesa. **Ekipi i IEP^{së}** do të përcaktojë, nëse fëmija juaj mund të marrë pjesë me sukses në programet që ata dëshirojnë që të aplikojnë, bazuar në mbështetjet dhe shërbimet të cilat janë cilësuar në IEP^{të} e tyre.
- Qëndroni në kontakt me këshilltarin psikolog të shkollës lidhur me afatet e fundit për provat e dëgjimit, intervistat, dhe dosjet e punëve më të mira (*portfolio*). Flisni me organizatat e shkollës dhe komunitetit për të marrë nga ata letra rekomandimi për pranimet në programet e shkollave me kriter dhe ato me pranim të gjërë.
- Flisni me këshilltarin psikolog të shkollës rreth datave dhe përgatitjeve për **intervista, prova dëgjimi, dhe dosjeve me punët më të mira (portfolios)**.
- Nëse fëmija juaj **nuk zgjidhet** në ndonjë nga shkollat që janë me Kritere në Pranim ose në shkollat me Pranim të gjërë në bazë llotarie, **që keni zgjedhur në aplikimin tuaj**, ju do të merrni një letër në **pranverë** bashkë me informacionin lidhur me **Proçesin e Paanshëm 'LeGare'**. Kontaktoni këshilltarin psikolog të shkollës për informacion shtesë.